
TROKU I KALIT TË ZI
BEGZAT RRAHMANI
Kërçovë 2006

BEGZAT RRAHMANI

TROKU I KALIT TË ZI

-POEZI-

Kërçovë
2005

BIBLIOTEKA:MJELLMA

REDAKTOR:NAZIF SELIMI

RECENSENT:SALAJDIN QAZIMI
Qamil VELIU

LEKTOR:JAKUP MAKSUTI

BOTIMIN E VEPRËS E FINANCOI ZOTËRI SELIM SELIMI - PINJOLLI

QIRIRI I VERDHË

Natën se prisja
por ajo ishte futur
tinëzisht në dhomë
bashkë me trishtimet
dhembjet dhe prapësitë
e kohës moderne.
Iu luta yllit për shpëtim
ai s'dëgjoi ishte shumë larg
prita të vinte hëna
edhe asaj ia zinin rrugën mjegullat
ndeza qiririn e verdhë
që prej kohësh thahej në dhomë...

PAFAJËSIA

I duroja fashat e trupit
në turmën e plehut plot ofkëllima
që kundërmonin qelbësirë vdekje
duke na thënë:
pafajësinë tregojani Zotit
atje lart në katin e shtatë
dhe zbritni të lumtur
në jetën e amshuar...

JETA E HARLISUR

Ëndrra ka aromën e jetës në errësirë
njerëzit harlisen nëpër hapësirën pa fund
mëngjesi i ditës i gjen në përsiatje
përralla e horoskopit u fut në rrugë shkencore
ngjyrën dhe shijen e kafesë i sheh si fushë e bleruar
herë here bëhen xhelozë për djalë apo leshzezë
dhe rrugët e purpurta të yjeve në galaktikë
dikur kujtohen për jetën e harxhuar si uji në djerrinë?!

LËKUNDJET E DJEPIT

Valle mortore bënin mjegullat
së bashku me valët
ëndrrat shembeshin si kulla rëre
duke i shuar rrezet e hënës rinore
me ato sy përcjellës në fundin e ferrit
shuheshin shpresat e djepit që lëkundej
nga vaji i fëmijës i lidhur në pranga robërie
përherë i ngopur me uri të mallkuar
nga kufijtë e botës pa rrugë...?!

DREDHI GJARPRI

Gjarpri me kokën lart në qiell
mbi sipërfaqen kësulë breshke
bënte ca numra të çuditshëm
ajo ngadalë me këmbën e majtë
ia gërvishte bishtin e pistë
kurse me të djathtën bënte hapa
shqiponja nga lart e shikonte me kujdes
çapkënllëkun dhe jo rehatinë e breshkës
dikur u bind për egërsinë gjarpërore
dhe iu vërsul me tërë forcën e saj...

QAFA E UJKUT

Armiku pa ndalur na pinte gjakun
dhe ankohej për t'i zhdukur gjurmët e krimit
ne shkuam e pyetëm plakun e fisit tjetër
që kishte pasur të njëjtin dert
ai me shumë nervozë na tha:
-a dini pse ujku e ka qafën e trashë?!
Frëngjitë duhej hapur për armikun
dhe me plumba ta qëlloni në kokë
mjaft u bëtë copë e thërrmijë...

TROKU I KALIT TË ZI

Sokakëve të qytetit për në Anadoll
ëndërroja trokun e kalit të bardhë
që dikur i shaluar ecte kodrës së kishës
dhe i lumtur pritja me padurim takimin
e asaj që më priste te Guri i Cucës.
Shpejt ylberi i zjarrtë më mbështolli
në kujtesën e asaj që iku pa kthim
duke mallkuar fatin e viteve
kur nëpër vrimën e xhamit
përfundoja hartimin e nisur
për ndarjen e zemrave plot lot e vaj
kur te kodra e kishës trokun e kalit të zi
përgatitej për në Anadollin e largët
ku lumturia treti përgjithmonë...

LIMFA KTHEHET NË GJAK TË KUQ

Rrënjët tona janë të thella
nga toka jonë mëmë
pa ndalur thithin ushqim limfatik
që në trupin tonë kthehet në gjak të kuq
për revitalizimë dhe ripërtëritje rodi
rrënjët tona s' takohen as në ëndërr
me mbretërinë e vdekjes shfarosëse
ne për të zënë mik nga larg
e gdhendim mirë trurin...?!

SHKRONJA TË SHTREMBËRUARA

Caranjtë kalbeshin gurët thyheshin me emër e mbiemër
te varri moçëm të Burrit Historimadh
duke na lënë mistere në vatrën tonë denbabaden
qielli mbushej me stuhi e dallgë të ftohta nga ardhacakët
që kockat e varreve i zëvendësonin me të huaj
duke i konservuar në qeska të ndyra rrena karpatesh
bashkë me shkronja të shtrembëruara e të pakuptueshme për ne
por toka e pastër e kalbëte huajsinë-
duke ruajtur shkronjat dhe gravurat e kockave të njeriut të moçëm...

MASKARENJTË NËPËR KOHËRA

Ferra të bënë të çalë të amputon këmbën
gjaku i prishur të ndyn fytyrën të amputon trurin
qetësinë e varrit dhe Parajsën ta bëjnë tym e flakë
vërtetë meritojnë fjalën kaurë dhe maskarenj
si gjarpërinj nxjerrin kokën të kafshojnë me hile
të bëjnë be: në je Turk mos na ngitni
s'kishim qëllim të keq deshëm helmin ta mbjellim
ju keni shumë Kolosë nëpër kohëra ç' duhet edhe Kjo(Nënë Terezë)
keni emër bile edhe mbiemër fluturoni si flamuri
s' bëhet nami për këtë që ua marrim me poshtërsi
ne prapë Ju lutemi dhe Ju bëjmë be:
-Në jeni Turq lëna rehat Ajo besonte në KRYQ...???!!!

VALËT E LUMIT PA SHPIRT

Më erdhi keq për shpirtin tim të kristaltë
kur valët e lumit të pa shpirt e përplasnin nëpër shkëmbinj
duke i dalë përpara breg më breg e ai humbej si hije nate
unë ndihesha si kopsht pa aromë lulesh dhe këngë zogjsh
edhe hëna me rrezet plotë lot lutej të më kthente shpirtin
ai vazhdonte luftën me valët e tërbuara të lumit pa shpirt
dikur tha:këto qenkan përkundjet e gjumit të përjetësisë
prej diku larg dëgjova ulërimën që vinte nëpër rrezet e hënës...

QIELLI I ROBËRISË

Plumbat çanë qiellin e robërisë së zogut në fluturim
bashkë me mjegullën e zymtë që gjëmonte këngë trumbetuese
për vdekjen e gjakut të çmendur në qiellin e paguar shtrenjtë
duke i vënë akuza krimi të mjeshtërisë ortodokse
bota mbështillej në rrjetën e merimangës-vejushë tradhtie
duke përzënë ata me rrënjë të thella e krahë të gjatë...!

SHPIRTRAT E LËNDUAR

U rrasëm me këngë trimërie vajtimi e dashurie
por dhe plagë në zemër të luftës përjetuam
varret i hapnim për tragjedinë e zezë pa dhimbje
pasi mirësinë na e shkruanin si mëkat me kërtylje
shpirtrat e lënduar kurrë se harruan shtëpinë e vjetër
durimi vyshkej duke ringjallur zemra trimash
me plakun në ballë duke shpaluar histori rishtuese
për oborrin plot rrugë pezhishke me ecje hijesh të padukshme
çdo kulm përgjakej me këngë shpendkeqve...?!

KOLOSËT

Dituria vazhdon rrugën nëpër shtresa
si shndritje zejesh nëpër univers
duke lëshuar gjallëri si shiu në tokë
për ripërtëritjen e krijesës njeri
pasi erërat zhdukin njerëz por jo fytyra
ata hapin rrugë e dritare për mendime pa fund
duke lënë gjurmë jete për dije e përjetësi
si aromë lulesh në kopshtin Parajsë
duke shfletuar titujt plot mrekulli
kurse erërat me unin KURM
cofin nëpër tufan si flluska sapuni...

TOPI I DJALIT TË PASHAIT

Valëzonte liqeni i Janinës
si në kohën e pashait të madh
duke formuar damar gjaku
që merrte teposhtën
për të ripërtërirë Artën dhe Prevezën
prej sëmundjes plot rënkime
të shekullit ortodoks
inhalacioni i damarit
dukej si ugar pranveror
pleqve ua lironte frymëmarrjen
kurse të rinjve u jepte:
-DIJENI DHE FORCË ILIRE-
ai vazhdonte rrugën
për në Valtosin e Pargës
për t'u ngjitur në Kala
te topi i djalit të pashait...?!

LIHNIDA PARTALLE NË SHKOP

Kokat të ngulura në hunj pas shpine
shikonin gjymtyrët e ndara nga trupi
dhe sytë e skuqur për pushtet të kalbur
Lihnida partalle e bardhë në shkop
me kataroshët që kënaqen me tul fëmijësh
duke rrëmbyer tinëzisht fjalën e shenjtë komb...?!

PLAGË E ASTMËS

Duhmën e astmës e përzura
me aromën dhuratë të Kefirit
që erdhi ngadalë me plakun
plot shëndet e freski malesh
kollën dhe dhembjet i griri
si rërë deti duke mbuluar
-PLAGËT E ASTMËS-
të pa mëshira copëtonin mushkëritë
për të gjetur thesarin-VDEKJE-...?!

RRËNJA E FJALËS SHFAROSËSE

Dikur më stolisën mbiemrin
me rrënjë fjale Karpatesh
për qëllim zaptimi e shfarosjeje
të tokës së bukës që e kemi dhuratë
nga vetë Zoti për trimëri mejdani
dhe heronjtë na i bënë me histori
të dyshimtë me përralla trishtuese
gjyshërve ua shterën bisedat
skamja ua shkriri edhe metalikun e fundit
me qëllim të përçarjes në –KULLËN E GURIT-!

PIKTURIM MENDIMESH

Në qetësinë e natës Hëna pikturonte
mendimet e piktorit me penelin e gjatë
plotë ngjyrë Ylberi me plagë njerëzore
duke i këputur Yjet nga shpirti i piktores
kurse zogjtë e vajtonin duke u kotur
nëpër ëndrrat e dashurisë së humbur
së bashku me hapat e trembur të drenushës
nëpër natën e ndezur flakë qiellore
duke kërkuar ujin e përroit plot lot etjesh
derisa natën filluan ta përpijnë rrezet e diellit!

VAJTIM I ZOGJVE NË FLUTURIM

Peshimi i fjalëve fortesë guri e themelit historik
duke u ngjitur jetës përpjetë nëpër rrugët e rënda të kohës
me kryqëzime shpatash për mendime e pasuri antinjerëzore
me katarakte gjaku që mbushet qielli e toka me lot e plagë të pashërueshme
që sa herë kemi parë sy e zemra fëmijësh të renditura në karikatorë
duke vajtuar zogjtë në qiell nëpër rrugët e tyre pa kthim
për prangat e fjalëve në themelet e shtëpive të rrënuara...

TE URA E DRINIT TË ZI

Takim shpirtrash
të njerëzve poshtër
nga shteti i coptuar
nën flamurin e përdhosur
me prapavijë politike
vite me radhë
te URA E DRINIT TË ZI
SHQIPONJA bëhej sorrë...?!

MJEGULLAT E VDEKJES

Dikush ajrin ma drynosi
në bombë të çeliktë
edhe varrin ma hapi para kohe
që emri të zhdukej pa gjurmë
drynin e shkatërrova me dhëmbë
kurse varrtarët i vranë fëmijët
bombën e futa në xhep
me hisen e ajrit për jetë
me thonj e gërvishta mjegullën e vdekjes
që pengonte prej kurrë aromën e jetës.

MADEMI GURBEVE

Vargun për ty e kam filluar vendlindje
atëherë kur Zabit Zhubrina
ka shkrepur plumbin e armës pa leje
kurse unë kam ndalur vajin në djep
dhe paskam lëshuar një pordhë burri
gjyshja paska thënë:
-ky s'do të trembet nga kaurët tamam si Zabiti
të nesërmen Zabit Zhubrina te Mademi i Gurbeve
ka palosur një duzinë xhandarësh...

SHKËMBINJ BURGJESH

Edhe shpirti iku
prej plagës së hapur
që ringjallte epshe pa shpirt
të zemrës plot plagë
nga gjaku i prishur
prej mishit kujtesë gjarpri
që shtriu dorën thimth të helmuar
nëpër shkëmbinjtë e burgjeve
të thyer prej muskujve tonë
si statuja të bardha
që fluturojnë si tinguj
dritash të qiellit pa fund...?!

STINËT E KOHËS

Nëpër buzët e thara eshkë
kalon lumi pa fund
që ndez zemrën qëndresë
si shkëmb plot plagë kohe
erërënda e të mykët
për diellin e qiellit të përgjakur
nëpër stinët e kohës plotë dhimbje
që nguliten në historinë
e kombit të shpërndarë
dhe të ndarë me bedena gjemborë.

SHIJIM I PARAJSËS

Në Parajsë s'ka dete
as lumenj me ujëra të kulluar
atje ringjallen epshet pa kufi
që i shijon si në ëndërr
plagët e trupit rrokullisen nëpër shkallë
copëtohen si himen vajzërie
epshet edhe më shumë ringjallen
vuajtjet i merr vala e lumit
i dërgon në Ferrin e jetës mëkatare
pëllumbat ngelin të bëjnë dashuri
me Lulezonjat e porsaçelura
karafilat ua hijeshojnë kurorat
sofrat e gotat mbushen e zbrazen
por pa ngimje e dehje
kurse dita e haresë zgjat
sa një jetë njeriu...

SHTRYDHJA

Kur e shtrydha qytetin
darët formuan një rreth
me dy vega për kapje
atëherë robotët ecnin si hije
duke shkelur njerëzit e vdekur
kurse aktorët dhe piktorët
kërkonin poetët
që t'i jepnin jetë qytetit
ata shkonin përreth qytetit
që diku ta këputnin
por rrethi kthehej në rrjetë
merimanga rrotullohej
me shpejtësi marramendëse
duke vjellë qelbësirë
gjersa nga poetët u frikësua
dhe u zhduk bashkë me rrethin...?!

EPSHE PA FUND

Sonte dashuria u bë
me ëndrrën e valëve të liqenit
ku rrokullisej
si bollë Qikllop flokëgjatë
shtatë krerë e një gojë
pa organe të mbarsmërisë
por e epëshuar
si valët e liqenit pa fund...

ENGJËLLI

Shpirti rrinte pezull
mbi trupin lakuriq
të engjëllit fëmijë
në botën e dhunuar
ku edhe Zoti
ishte i pamundur
në polarizimin
e dy botëve!

PREJ NESËR

Me duart e urrejtjes
shkyçën telat e rrymës
me çelësin e mbylljes
s’lejuan ujin në kuzhinë
“Flaka” shkruante
për paralelen e padëshiruar
në qytetin e alfabetit
një rreze errësire
më binte trurin e trullosur
mjeku më këshilloi
për ushqim pa yndyrë
unë qeshja
me xhepin pa asnjë lek
gazetashitësi më uroi
duke u zgërdhi
për mosdaljen e Flakës...?!

TRURI I GRISUR

Kokën e përplasa
për gurit të themelit
të arnoj trurin e grisur
prej dijenisë së fëlliqtë sllave
gjilpëra thyhej peri kalbej
gjersa e shtrydha trurin
dhe helmi kthye
te pronari gjarpër...?!

LABIRINT GJAKU

Varret i mbyllnin
në labirinte gjaku
për të zhdukur rrugën tonë
kurse ne frymonim
lëshonim rrënjë dhe pika gjaku
duke shënuar rikthimin
pasi ai gjak kalbte
derën e labirintit mbyllës.

GJUMI MORTOR

Tronditja e anijes
nga valët e tërbuara
dhe zëri i pulëbardhës
largonin gjumin mortor
të timonierit të rraskapitur
nga rruga maratonike
për të treguar virtytet
e kombit fisnik...!

LOTI

Loti i motrës
hap krater
dhe vullkan të pashuar
në zemrën e vëllait...?!

DORA NË VALËT E DETIT

Kishte ngelur dora
si dru i njomë në dimër
mes valëve të tërbuara
të detit pa shpirt
duke dashur valët
t'ia këpusin gishtat
që i jepnin pak gjallëri
valët vinin kryelarta
me qentë e Ballkanit
por ktheheshin të turpëruara
pasi s'ishin në shtëpi të vet
dora ngelte e pa luhatur
si shqiponja në fluturim...!

VARGJET E DRURIT TË THINJUR

Prej degëve të drurit të thinjur
më lindën vargje aromatike
me ngjyrat e spektrit në horizont
që dikushin e bënin skeptik
pasi vargjet s’gjenin rehati te ai
dhe ngelnin enigmë e pa zbërthyer
dhe lëngonin nga padijenia njeri
duke u munduar si vullkan në brendi të tokës
thyenin eshtrat e skeletit njeri pa shpirt
gjersa lava e vargjeve aromatik
të shpërndahet nëpër zemrat e rruzullit tokësor.

PLUMBAT

Mjekra iu rrit
flokët u zbardhën
dhëmbët i ranë
buka u zhduk
motin e kapi
një shi pikëllimi
por lugët iu bënë
-PLUMBA-

AROMA E BUKURISË

Tastierat akoma lëshojnë
melodi korçare të vilajetit
prej asaj që prehet
nën mollën e moçme të
    -MAMAJES-
ku fustani primadonë
lëshon aromë kombi
dhe të deh nga bukuria
e trupit të gdhendur
nga talenti krijues i kohës
për shpirtin Eros...?!

SHKRUMBIM I SHPIRTIT

Edhe pse larg
kanë shkuar poetët
dhembjet i ndjejnë
thellë nga brendia e tokës
e shpirti u shkrumbohet
prej flakës që ndjek fëmijët
me çantat plot libra
e pak bukë Kosove...?

SHEKULLI I MURIT NDARËS

Në tokën tonë
mbollëm shpirtin e lules
aroma e saj dhimbesë
të na mbajë gjallë
me ngrohtësi
edhe në ditët plot acar
e rrënjët të rrënojnë
murin ndarës të
-SHEKULLIT-
që e ndërtuan ata
që urrejnë fjalën fëmijë
prandaj Zoti ua fali
sterilitetin dhe dashurinë e ftohtë!

AMANET KARPATESH

U krijuat prej farës gjarpër
kur nëpër terrin e natës
nëna bënte aktin e ndyrë
me krijesën pa vetëdije
prandaj bëri vepra të shëmtuara
që i keni amanet thatësie
ne dhe bota s'jemi si para një shekulli
prandaj të shtypet koka
gjersa të del fara gjarpër
prej qendrës Ballkan
t'i kthehesh vendit të zanafillës?!

GREMINA

Drejt udhës greminë
dorë për dore ecni
akademikë pa merita
duke u lutur për shpirtin
e fëmijëve si qen të zgjebosur
duke parë fatin e tyre
në fatkeqësinë e të tjerëve.

MJEGULLAT E LOTËVE

Avalla me fiks vaksinat
mbollën plagën e përgjakur
në trupin e meteorit-Uskana
që ndeshet me temperaturë siberiane
që del nga krateri kuçedër
duke thirrur rreze mjegullash
të lotëve të karbonizuar
të kapi pikën e vesës
për ripërtëritjen e mushkërive të
-METEORIT USKANA-
dhe gjarprit t'i hiqet helmi
me shiringë thatësie
për ulërimën njerëzore
nga kryqi sllav i viteve...?!

TIK-TAKET E ORËS

Këtë natë plot terr
tik-taket e orës
më gërvishtin trurin
pa pikë mëshire
duke u thelluar
në damarët e shpirtit
për të larguar me dhunë
nga trupi im i lodhur
vitet e kaluara me plotë
histori kasapësh
për shpirtin njerëzor
që linden nga njerëz të dehur
me kryqin e përgjakur në zemër
për emër të vet
shkatërrojnë themelin e shtëpisë...?!

SHPIRTI I TOKËS

Hëna me rrezet
shqyente errësirën
për t’u freskuar
në zemrat e fëmijëve
të pa strehë dhe prindër
në skajin e përroit
me ujë kristali
gurgullima shërim plagësh
dhe ringjallje jete
për luftë vatani
ku shpirti i tokës
shndërrohej në pinjoll kombi.

PLUGIM TRURI

Eshtrat bënin
plugimin e trurit
për farë përdornin
gjakun arian
për dredhitë e kryqit ogurzi
duke u dridhur truri bërtiste:
-mblidheni rreth trungut
boll u ranë në qafë
duke ua prerë degët
dalëngadalë do t’u thajnë rrënjët
dhe trungu do të bie...?!

TRURI REBEL

Sonte lotët lexuan vjershën
duke luftuar me terrin e zi
truri plot ide për ngjyrën e letrës
të shtëpisë së rrënuar për lindje fëmijësh
në acarin e mbërthyer me rrjetë merimange
filizat lindnin bashkë me poezinë e trurit rebel
kurse asaj i plasnin sytë e përgjakur?!

PAS EKSTAZËS

Prej rrëkesë së gjakut
ringjallen epshet e sëmurë
jeta shuhet me ekstazë shtazarake
botën e kap terri
lehona merr fëmijën në gji
duke i shpëtuar shtazarakut
bota premton ndihma
për vendin pa gjallëri
dhe ëndrrat gjatë ekstazës
të betuara në kryqin e zi...

GJAKU I BASHKIMIT

Dimri akulloi stinët
duke plagosur diellin
me dhimbje vdekjeje
në tokën e djegur
të mbetur vetëm një ushtar lirie
me flamurin pikë të zezë
në truallin e mbuluar me gjak
duke rrafshuar me shtizë dimrin acar
për tokën që kurrë s'e kurseu
gjakun e bashkimit...

SHARJA E TRURIT

Muzgu më përcëlloi mendimet
dhe m’i ngurtësoi buzët
fjalët më kalben bashkë me mushkëritë
duke u bërë kufoma të pa dëshiruara
për tokën që s’dhashë asnjë pikë gjaku
sytë më plasën si kokoshka
por ‘ derdhnin asnjë pikë loti
-SHAJNË TRURIN-

QIELLI PURPURONTE

Te shkëmbinjtë e albatrosit
valët duke qarë shkumonin
për rrezet e diellit që zhdukeshin
atje thellë ku peshkaqenët i gëlltitnin
qielli purpuronte nga lëndimet
shkëmbinjtë merrnin pamje vdekjeje
pulëbardhat vinin nga larg
duke kënduar në kor
për gostitë që kishin pasur
kurse albatrosët lodhnin trurin
për ditën që vinte plot re të zeza.

HIPNOZË GJARPRI

Shkathtësi truri
për dinakëri naive
me hipnozë gjarpri
të kohës moderne
për koka hendikepi
dhe të lindur
para kohe...

LAVA E SHPIRTIT

Shikoj përmes pasqyrës
ndryshimet e relievit tim
që i lëshojnë rrënjët thellë
në zemër e mushkëri
duke gropuar trurin
për lavën e shpirtit
që digjet me shekuj
për të pastruar trurin
nga paraziti egërsirë
që pa ndalur ma ka thithur
gjakun e damarëve
për të ushqyer këlyshët
që i përgatit për parazitë.

VIRUSI SHPIRTIT KATIL

Këtë natë lëngon hëna
prej gjakut që i rëndon në tru
shkëlqimi i rrezeve zbehet
nga fytyra e përgjakur nga lotët
ylli i rrinë afër duke ia mikluar trupin
për t'i ndalur dhimbjet që vinë nga rreze të zeza
nga virusi i shpirtit katil që kurrë s'ka pasur
rrënjë në planetin e quajtur tokë...?!

GRAVURË TRURI

I ri ngele në mermerin e ftohtë
rrezet e hënës e diellit afrohen
të të ledhatojnë e ti u buzëqesh
duke shkarravitur në fletoren e hapur
pasi askush s' ti trazon mendimet
as huti i natës
as gjinkallat e verës
fletoren e rëndë s'e lëshon
që të mos të vriten mendimet
lapsi i shtanguar në dorë
bënë gravura në trurin e lodhur.

RREZET E PLAGOSURA

Nëpër rrezet e yjeve të natës
kacavirreshin fëmijët e fisit tim
që t'i shmangeshin orës së keqe
dhe sëpatës që mundohej t'i priste
dhe të binin në kazanin e vdekjes
bashkë me rrezet e plagosura
për gjarprin që jetën
e shndërronte në gërmadha hiri
bashkë me bereqetin e verës
për t'u kënaqur me krimet
njerëzit monstrumë...?!

MBLEDHJE GJYMTYRËSH

Damari përbiroi Sharrin
për të ushqyer tokën e djegur
të zbuti pak dhimbjet
në plagët e hapura
e të lulojnë ndryshe bozhuret
bashkë me zogjtë në foletë e reja
me krahë të shëndoshë
lokja e lumtur të përgatisë djepin
që fara e zezë me vjet i la thatë
toka e djegur të japi bereqetin
lisi i moçëm sa vetë toka
të mbledh gjymtyrët e ndara
nga përçarjet nëpër rrebeshe.

NUSËRUAN NUSET PA NUSËRI

Prej meteorit të shuar
shikoj të zhveshur mëmën tokë
prej petkut të bukur pranveror
e mbështjellë me pamje vdekjeje
zemrat ngrinin në trupa të njomë
ujku ia kërcëllonte dhëmbët te dera
duke mos guxuar të hynte brenda
pasi në tru i përplasej një rrufe
që e grimoi duke e fshirë prej tokës sonë
atëherë nuset pa nusëri nusëruan
kurse toka zhveshi rrobat e vdekjes.

HELM KUNDËR PLUMBAVE

Dritaret nuk kapeshin nga lagështia
e dimrit të egër në muajin e pestë
derën e thyem me pak eksploziv
sytë i fërkuam me qepë të bardha
helmin e pimë ushqim kundër plumbave
nxënësit i kishin tredhur barbarisht
ca të tjerë i kishin përcjellë diku larg
për t'u dhënë emrin kopilë për luftë
shumë vajza kishin vdekur nga turpi
shkolla kishte marrë pamje vdekjeje
në horizont purpëronte kryq
i yllit pesë cepash të thyer
një shkabë u sillej vërdallë
gjersa i zhduku prej atarit të vet...

VALON FLAMURI I BUKËS

Shiu kafenetë i mbushi plot verë
hardhitë u zhdukën me erën pa vjelë
klientët deheshin qysh herët prej aromës
letrat e bixhozit shndërroheshin
në mish të pjekur për meze
tregtarët habiteshin klientët i përqeshnin
nëpër pasqyrat varur nëpër mure
duke u hedhur pas shpine nga një jelek
nesër thoshin:do të jetë edhe më mirë
tash ne u kemi si peshqit në tavë
tregu dhe qyteti më s'janë të juaj
çdo gjë është hapur si qielli për zogjtë
që na sjellin fruta nga larg
kurse nëpër ara valon flamuri i bukës
ne jetojmë me ëndrrat e dehura të ditës...

KOKA E POPULLIT

Rrudhat e ballit
dhe këmbët e zbathura
bëjnë gjurma si thundrat e kalit
në shkëmbinjtë e fortë
duke i mbledhur gjymtyrët
dhe pjesët e trupit
për kokën e popullit
në kullën e vjetër të gurit
e ndarë në shumë pjesë pa hise
e ndarë me mure por e lidhur me damarë
shpirtëror të nëntokës
kazma barbare s’mund t’i shkuli
por as me tru të mykur
dhe dhëmbët katarosh!

DUKE ECUR RRUGËS

Ecja si përherë rrugës sime
pa të keq shikoja si të tjerët
atë të mësuarin shok të fëmijërisë
ai na shikoi me të keq dhe i vrenjtur
duke më sharë kokën qel
heshta duke iu ankuar një plaku të mençur
aty afër në parkun e qytetit
i habitur më tha le të shkojë në... të nënës së vet
i tregova vëllait prej nëne e babe
na bëri të marrë si mua ashtu edhe plakun
vazhdova duke parë luftën e degëve me erën
dhe gruan shamizezë me fëmijën në gjoks
duke përtypur kafshoren e bukës së tharë nga koha
u ndal buzëqeshi e më tha:
-edhe ti je plot halle bir...?!

QIELLI I KUQËRREMTË

Nëpër xhamin e thyer të kullës
shikoja pikturimin e natyrës
dielli më ikte nga shikimi
qielli më bëhej i kuqërremtë
bilbili vajtonte diku në afërsi
një fëmijë puthte dorën e vëllait
që pak më parë e kishte gjetur
në pluhurin e rrugës
bashkë me kokë,këmbë e gishta
me shumë kujdes i paloste
aty në skaj të rrugës
për t'i parë të afërmit e djegur
dikur vonë nëpër xhamin e kullës
hyri një rreze e ngrohtë dielli...

FRAGMENTET E JETËS

Acari dhe mjegullat e zeza
me krongjijtë gjer në tokë
ndalën cicërimën e zogjve
shtuan vajin dhe mjerimin e fëmijëve
matrapazët kënaqeshin me përfitimet
duke parë në popull litarin për fyti
klerikët pritnin ditën me padurim
për të kryer punën profesionale
hovin ua ndali fryma e jugut
me ripërtëritjen e spermës
zërin e bukur të kanarinave
dhe aromën e bukur nga skaji i botës
duke i mbytur egoistët dhe sadistët
që kurrë s'kishin menduar për ëndrrën e trishtueshme
dhe fragmentet e jetës plot krongjij gjaku...?!

UDHËKRYQI I JETËS

Atë natë nga kënga e lahutarit
mjegullat rëndonin sa pesha e trimit
që ndeshte mendimet në udhëkryqe
duke ia shkallmuar trurin si rrufeja shkëmbin
sa mundohej të largonte mendimet
diç i vinte në kokë si shigjetë armiku
duke ia kapur ëndrrat si perëndim dielli
dhe ia errësonte rrugën me errësirë të dendur
monodramës njerëzore në oazën e paqes...?!

MBARËSI I KOBIT

U zbarkua nga retë e mëndafshta
për botën miope të këtij shekulli
në mushkëritë e virgjëra të meteorit
duke e mashtruar edhe atë me bishtin
e një buçe për dashuri rebele
duke e mbarsur me kob të zi fatin
duke ia okupuar rrugët e jetës
me atë forcë në fyt që s'kapërdihet
që ta largojë nga mesi njerëzor
si jetën e lumtur të lules pranverore
duke ia afruar greminën ferr
nëpër bronket e mushkërive të thara!

TOKA EGËRSIRË

Shtëpia fillon të rrënohet
nga krrokat e mjegullës fatzezë
lajmet vonë nga labirintet
e yjeve që derdhen nëpër ëndrrat
e ditës të kufomës që kalbet
duke ua prerë degët IKONAT
piktura që s’ekzistojnë
kopilët e blinduar heqin valle
duke mos ditur për dashurinë princore
fëmijët vizatojnë pëllumba në letër
kurse kopilët i ringjallin në egërsira
duke thënë:ne vijmë nga toka egërsirë!

SHPIRTI I FJALËS

Nëpër kreshtat
e një vendi të huaj
me shekuj ruhet zëri
kurse vendlindja
e mbanë thellë në zemër
që një ditë t'i kthehet
e përzënësit t'ia thajë
gjakun në damarë
si akulli lulen
ditën e pranverës
pasi ai pa zë shkatërron,por
  -SHPIRTI I FJALËS-
del nga toka si FENIKS
nga lëkura e stinës sime...?!

ÇRRËNJOSJA

Në muret e rrënuara të Kalasë
shkaba e topit i bënte roje
shpirtit të Ali Pashës
kurse djali i bedemosur
luftonte me ortekët barbar
që donin ta rrafshonin me tokë
Rrapin e Epërm dhe të Poshtëm
Rrapjanët ndërtonin kishën
me elemente iliro-shqiptare
duke e çrrënjosur jonianin
nga tokat e Ali Tepelenës
shkaba e vulosur në Top thoshte:
"Çamjanët mua më kanë në shpirt"
valët e detit çoheshin përpjetë
Kalaja merrte erën e portokajve.

1-Rrapi i Poshtëm dhe i Epërm janë dy fshatra në afërsi të Pargës, të banuara nga shqiptarë.

TAKIMET E NATËS

Vonë do të them mirupafshim
nesër do të jetë herët
zëri me ngjyrë të zezë do të pikëllojë
në bebëzat e syrit do të më ngjiten
dy gjarpërinj me gjatësi pa fund
pa bishta e me dy koka
që groposin sy e zemër
prej goje do të dalin tri fjalë:
vatan,nënë e babë
fëmijët do të ecin nëpër terr
të huaj për njëri tjetrin
këngët e bardha i përpin zogu i zi
nënave u lidhen shami zeza
Amerika,Evropa na sjellin arkivole
me krimba krye zi e të blinduar
lumturinë do ta harrojnë Pallatet e Bardha...

ARKIVOLI

Trupin të nakatosur
e me një çerek syri
u ndal përpara nesh
në arkivolin e vulosur
ndihmë tha s'kërkoj
por ju keni përgjegjësinë
kurse historia le të shkruajë
për pabesinë e kryqit
unë gabimin e pagova me kokë
Zot pjella ime mos e pastë fatin tim?!

COPA RREZESH

Sonte zemra
nën rrezet e –Hënës Nuse-
bëhet copa rrezesh
duke pritur lajmet
e hutimit për inat djallëzie
drejt çatisë së kalasë të moçme
nga lisi mijëvjeçar
shkaba hapi krahët
duke ia zënë frymën kryqit
atëherë plaku shkrepi
të shtatë kraljive
frika u hyri në palcë...

HIPOKRATI S' ISHTE ATY

Dy orë bëra luftë
në Shtëpinë e Madhe
Hipokrati s'ishte aty
vinin më matnin kokën
më shikonin në mes të këmbëve
dhe iknin si të çmendur
nëna frikohej aty në afërsi
duke iu lutur Perëndisë
unë qetë kuvendoja me shpirtin
dikush erdhi e tha:
-përdorni tërë arsenalin
do të jetë i rrezikshëm
koka dhe...i rëndojnë
më tepër se trupi...?!

SHQIPONJA U KTHYE NË QIELL

Mjekra mu rrit
flokët u zbardhën
dhëmbët më ranë
kur u lëndua shqiponja
nga sofra u zhduk buka
lugët u bënë armë
vrasësit i kapi shi pikëllimi
duke llomotitur si përherë
nga varrezat e moçme
lindën (A)eliksiret
shqiponja u kthye në qiellin e vet!

DJERSA E SHTRYDHUR

Trurin e zhyta thellë
në baltën e truallit tim
ujin e kulluan
kallot e duarve
djersa shtrydhej
nga fjalët e plakut
që i thoshte me aq fuqi:
-trupin s’ma kalb toka...?!

ÇMALLJA ME VARGJE

Dita zvarritej nata shuante
gjallërinë që zgjatej një shekull
unë zhytesha në mendime pa mbarim
herë-herë çmallesha me vargje fëmijërie
dikush më përshëndeste rrugëve
por unë i humbur si delja jashtë kopesë
në mes të gjuhës që kurrë se kisha dashur
zhurma e parregullt më lodhte trurin
prandaj ngjitesha përpjetë si kanguri
të dëgjoj zhurmën e pikamerit
të minatorit plak të vendlindjes sime
por atje mu ngul turjela
siç më ngulej në tru ajo gjuhë barbare...

DËNIMI

Ti fëlliqësirë tokësore
kthjello trurin e pastro shpirtin
për jetën që s’është në duart tua
përkulen me vuajtje të papara
nën kthetrat e nepsit tënd
duke llogaritur për dënimin
që dikur do ta japish përpara popullit
por edhe përpara Zotit...

SUMBULLA LOTËSH

Oborri shkundi pluhurin
kur fëmija qau në duar të lokes
nga zemra i ranë në kërthizë
plot sumbulla lotësh
gjyshi tërhoqi këmbëzën
për trashëgimtarin e oborrit
duke thënë:
-tash do të prehem i qetë
në tokën e përgjakur?!

SHPIRTI I THYER

Gjaku që shpërtheu këtë natë
çfarë lumturie do të sjelli në jetë
nga shpirti i tij ndyrësirë
çfarë ëndrre e përlyer në shtrojën e pastër
që kundërmon-qelbësirë-jetë pasaniku
për zemrën e thyer që ëndërronte
lumturinë e vobekësisë në fundin e botës
lumturia makabre nga truri egërsirë
për prenë virgjëreshë pasuri e vobekësi
përqafim ëndrrash në shtratin dërrasë lulëzimi
ku tash përmbytej në divanin e bukur
nusja pa nusëri në amshimin e virgjër
me zemrën e thyer por shpirtin Parajsë.

HIMNI I GJINKALLAVE

Edhe pse të mërzisin
ato vazhdojnë me këngën
edhe atë me krenari
edhe kur ua merr jetën
thonë fjalën e fundit:
-Himni le të jetojë-

MOLLA E BEJLEGUT

Shija e frutave
zbukuron aromën e luleve
bashkë me melodinë
bletës ëmbëltuese
hija trashet për shtratin
e poetit që lufton me polenin
kënga e feniksit
trimëron mushkëritë
për mollën e bejlegut...

RREBESH MOTI

Natën e parë të nusërisë
unaza kërkonte gishtin e këputur
në gjerdekun e ëndrrave të virgjëra
e një rrebesh moti bënin tupanët
në errësirën e vjeshtës pa bereqet
dikush mbeti meit në ëndërr
duke menduar për mollën e mëkatit
dhe takimin e gishtit në Parajsë.

DALJE NGA FERRI
-Fishtës-

Shkelmimi i viteve
shndërrohej në pluhur
për oborrtarët e mjerë
duke mos ofshuar shpirtin
për meshën e popullit
që mbillej si këngë bilbili
në shpirtin e meshtarëve
duke ua hequr dhimbjet
e shtuar jetën...
kurse oborrtarët çmendeshin
pse hapej dera e Ferrit...

PLUMBA E KALASË

Dhembjet tona
plagë nëpër shekuj
si plumbat e kalasë
nëpër muret e frëngjive
që si zhduk koha
si gurët e ndarë
nga rrebeshet e motit
të mjegullës rebele!

RRUGËT E LECKOSURA

Mos i shqetësoni yjet
kur i ledhaton hëna
atëherë smira e diellit
zhduket si shkuma e detit
hëna e zbukuruar nuse
prej larg e përshëndet
me njërin sy
dielli i buzëqesh
dhe ngadalë rrëshqet
rrugës së leckosur
të shekullit atomik.

IDE TË MYKURA

Toka shtrydhet
si akulli në verë
prej krijesës noprane
me ide të mykura
kataroshët e kohës
rrëmbejnë fetuset
në muajin e parë
planetët frikohen
prej duarve të gjata
të njerëzve sakatë.

TAKIMI SILUETASH

Takimi ynë siluetë malesh
që turret si hija pas trupit
ta takojë në majë të malit
atje ku shqiponjat fluturojnë lirisht
nëpër mjegullat e Ikarusit
që fëmijët të hedhin shtat.

VARRET HAPEN PARA VDEKJES

Nga thellësia e detit
vjen një rreze zgjimi
për shpirtin e popullit
të robëruar me shekuj
nga pluhuri i palosur
të trurit të mykur
për lutje-falje
e kohë të humbur bisedash
për luftë të drejtash
pa copë toke me tapi
duke hapur varre para kohe
prej sadistëve të popullit të vet?!

GISHTA KËPUTËSIT

Historinë e shkruajnë
gishta këputësit
sekretet i mbështjellin
me lëkurë gjarpri
të botës së sëmurë
plagët rrjedhin
nëpër gishtat e bërë gjerdan
për laviret e prapavijës
varret gjëmojnë
shpirtrat shkruajnë legjenda...

HIEROGLIFË KOKE

Koka të është zbardhur
më thanë në pranverë
të paskan rënë flokët
më thanë në verë
Koka jote hieroglifë kohe
më thanë në vjeshtë
Tavani lëshoi lot ngushëllimi
pasi natës ia nxorëm
dhëmbët kataroshë
Në dimër
errësira ra në bunacë...!

DAMARËT E THARË

Shkel truri i juaj
mbi freskat e Onufrit
duke bërë plagë të thella
që as edhe vetë toka si kalb
qimet e brushave
i keni ferra në sy
ngjyrat ua ndalin gjakun
në damarët e tharë
feniksi i freskave
rrit popullin e vet.

XHINDET E NATËS

Në shtëpinë përdhese
në çati gjysmë të zbuluar
kalova natën e parë të martesës
në shtratin dërrasë ahu
i gdhendur me sëpatë
shiu që s'ndalej dëgjonte
ndodhitë nëpër xhamin e thyer
nga xhindet e natës.

GJAKIM NË ËNDËRR

Lart në qiell
ka vetëm një fjalë
    -LIRI-
kurse në tokë
jetë e padrejtësi
gjakim në ëndërr
truri i njeriut rropulli.

JETA

Jeta është libër
me prozë e poezi
data,muaj e vite
dashuri gëzime
politikë e hidhërime
vrasje e vetëvrasje
tradhti por dhe besnikëri,

NUSJA QIELLORE

Nëpër degët
e rrapit plak
kalonin rrezet
e nuse qiellore
duke grisur errësirën
e natës fantomë
të sheh sytë
e të bukurës së dheut
siç ndija ngrohtësinë trupore
dhe aromën e duhmës nusërore.

MBROJTJA E KULLËS

Jeta dhe besa vendosen
Në GURËT E KULLËS
kurse syri në frëngji
armikut nuk i mbyllet dera
as me vaj e as me këngë
por me tytat drejt tij...

RRUGA PËR NË PARAJSË

SONTE PIJË VERË

Pijë verë dalëngadalë
shpirti më thotë ca fjalë
linde mish që të bëhesh dhe
vera e kuqe eliksir për ne
hajet e pijet s'janë krim njerëzie
VEPRAT kriminele janë ndalesë PERENDIE
vera e kuqe të çon lart nga qielli
ENGJUJT të përcjellin si rreze dielli
shpirti e zemra ndizen flakë
pini verë nesër bëheni plak e plakë...

TAVERNA NË ERRËSIRË

Shishes së mbushur do t'ia gjejë atë fund
do të lodhem e rraskapitem do të jap shumë mund
e bardhë e kuqe për shpirtin ELIKSIR
ca herë hidhërohen fare s'kanë mëshirë
qajnë për verërat që i lanë bosh
bukuroshet e lodhura i hedhin në kosh
shikojnë hënën si perëndon me rrezet
zemra e shpirti të rraskapitur e epshi ndizet
në tavernën pa rreze ndiej qetësi
kënga e bilbilit ngadalë më thotë:
-eja pas meje në shtëpi...

NJOMËZOHEN BUZËT

Zoti u gëzua kur fali hardhinë
të dashuruarit me lezet verën ta pinë
vera e kuqe është NEKTAR për Zotin
shëron plagë njerëzore largon lotin
gjaku me ngut lëviz nëpër damar
njomësohen buzët që më parë kishin zjarr
taverna është plot miq e shokë
prandaj lindëm ne të dy vera e kuqe thotë
bregore e fusha lulëzojnë në agim
kur qyteti i zjarrtë pranon ledhatim...